

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësa Org. Org. Jedinica
 Org. Unit **KM-MIT**

Nr. i Faqëve Bc. Stranica
 No. Pages **2**

Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. **209/19**

Data : Datum : Date : **19.04.19**

PRISHTINE/A



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
 MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
 MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE
 MINISTRY OF INFRASTRUCTURE

Njësa Org. Org. Jedinica
 Org. Unit **01**

Nr. i Faqëve Bc. Stranica
 No. Pages **01**

Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. **4149**

Data : Datum : Date : **19.04.19**

PRISHTINE/A

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government
 Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërurban të udhëtarëve me autobus, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 06/2016 dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

I. Aprovohet pjesërisht kërkesa nr.2130 e operatorit të transportit rrugor të udhëtarëve me autobus N.T.P. "Bala Reisen" me seli në Istog për marrjen e nisjeve në relacionin Istog-Klinë- Prishtinë dhe anasjelltas perkatesisht aprovohet vetëm pjesa e kërkesës lidhur me nisjen e tretë me orare të nisjes (18:00 - 20:05) .

Arsyetim

Pas shqyrtimit të aplikacioneve dhe verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi repektivisht Ligjin nr.04/L-179 për Transportin Rrugor në mbështetje të nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndër-urban të udhëtarëve me autobus i plotësuar dhe ndryshuar me Udhëzimin Administrativ nr.06/2016, është konstatuar që operatori transportues rrugor të udhëtarëve me autobus N.T.P. "Bala Reisen" me seli në Istog ka plotësuar kushtet ligjore për ndarjen e

nisjeve të lira në relacionin e lartëcekur të përcaktuara sipas nenit 8 të U.A nr. 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit në transportin nderurban të udhëtarëve me autobus si dhe kushtet e shpalljes publike për marrjen e nisjeve në relacionin Istog-Klinë- Prishtinë dhe anasjelltas perkatesisht aprovohet vetem pjesa e kërkeses lidhur me nisjen me orare të nisjes (18:00 – 20:05) pasi që referuar evidencave zyrtare që posedon Departamenti i Transportit Tokësor operatori në fjalë posedon 5 (pesë) rende të udhëtimit valide për operim në transportin ndërurban si dhe nje leje per operim ne transportin e veçant te udhetareve me autobus brenda territrit te vendit , ndaj në bazë të kapaciteteve që disponon nuk mundet të mbulojë nisje të tjera respektivisht nuk posedon kapacitetet teknike te mjaftueshme për marrjen e nisjeve të tjera.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë, është vendosur si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrojë ankesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Transportit brenda afatit prej shtatë (7) ditësh nga dita e publikimit të vendimit.



I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Kabinetit të Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Operatorit Transportues;
- Arhivit.